# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-439445**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Goditet një pikë karburanti pranë kufirit me Poloninë, ministri ukrainas: Terrori i Putinit po troket në dyert e BE dhe NATO-s |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/goditet-nje-pike-karburanti-prane-kufirit-me-polonine-ministri-ukrainas-ter-i585765` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 09:36:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 10:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3aab77a4a6b72d4f0c45c1f0ac0e039deb940f719b600d8a1c43889db5ff7288` |
| TEKSTI | `9190b60c56a4562de8934b30a84efbe81dcf72f7010876c8097f2aa9c5ffa0b7` |
| PAMJA | `8bf2e83c79a6d56c94b786d54f2170f30e35355e656fdd4ddd3e367a7de05cc0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a06025700bf3432a06626c168a376e86bf63eb17f6b9e035897bcb3e9980d42f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a06025700bf3432a06626c168a376e86bf63eb17f6b9e035897bcb3e9980d42f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Goditet një pikë karburanti pranë kufirit me Poloninë, ministri ukrainas: Terrori i Putinit po troket në dyert e BE dhe NATO-s

13 Shtator 2026, 12:50Bota TEMA

Goditet një pikë karburanti pranë kufirit me Poloninë,

Një pikë karburanti në Yahodyn, pranë kufirit të Ukrainës me Poloninë, është goditur gjatë një sulmi masiv me dronë ndaj Ukrainës. Sulmi shkaktoi një zjarr të madh, ndërsa pranë pikës kufitare raportohet se janë përfshirë nga flakët edhe disa kamionë.

Ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha, e cilësoi sulmin si “terrori i Putinit” dhe paralajmëroi se Rusia po kërcënon drejtpërdrejt kufijtë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Ai u bëri thirrje partnerëve ndërkombëtarë të mos vonojë dhe ta ndalojnë Rusinë para se të jetë tepër vonë dhe të forcojnë sanksionet ndaj Moskës.

*"Ky është terrori i Putinit, i cili po troket drejtpërdrejt në dyert e BE-së dhe NATO-s. Barbarët rusë janë tashmë në derën tuaj, partnerë të dashur. Veproni tani: lëshoni peshën e plotë të sanksioneve tuaja kundër regjimit agresiv të Putinit. Sigurohuni që Moska të paguajë pasojat. Jo masa gjysmake, por hapa vendimtarë dhe pa kompromis. Një embargo totale tregtare. Ndalime absolute hyrjeje. Sanksione gjithëpërfshirëse kundër kompleksit ushtarako-industrial", shkroi ministri në X. "Putini duhet ta kuptojë se barbaria e tij do të përballet me një përgjigje të fortë, të aftë ta bëjë koston e luftës të papranueshme për të. Kjo është e vetmja mënyrë për ta ndaluar atë"*, deklaroi ai.

Ndërkohë, Moska deklaron se Kryeministri indian Narendra Modi dhe Presidenti kinez Xi Jinping kanë ofruar ndihmën e tyre për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhjeje për luftën në Ukrainë. Sipas Kremlinit, Vladimir Putin e ka mirëpritur këtë gatishmëri.

Në një tjetër zhvillim, i dërguari special i Presidentit amerikan Donald Trump, Jared Kushner, deklaroi se pjesa kryesore e një marrëveshjeje për përfundimin e luftës është përgatitur. Sipas tij, pengesa kryesore mbetet çështja territoriale dhe gatishmëria e Kievit për të pranuar territoret e kërkuara nga Moska.

*“Nëse Ukraina do të pranonte të dorëzonte territoret e kërkuara nga Putini, do të kishim tashmë një marrëveshje”*, deklaroi Kushner.

Rusia shpreson që së shpejti të zhvillohet një raund i ri bisedimesh trepalëshe mes Rusisë, SHBA-së dhe Ukrainës, ndërsa çështja territoriale mbetet një nga pengesat kryesore për një marrëveshje paqeje.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Mes tensioneve me SHBA-në, Kanadaja i drejtohet Evropës për të forcuar lidhjet]

11:10 Bota

[Kongo përballet me shpërthimin më të rëndë të Ebolës, mbi 7 mijë raste dhe afro 4 mijë viktima]

09:40 Bota

[Ukraina përgatitet për një dimër të ashpër ndërsa sulmet ruse godasin ekonominë]

09:30 Bota

[Zgjedhje vendimtare në Suedi, ekstremi i djathtë vetëm një hap larg pushtetit]

09:10 Bota / 4 komente

[Qindra emigrantë të dëbuar nga Britania zhduken në Francë, Parisi kërkon anulimin e marrëveshjes dypalëshe]

08:30 Bota / 8 komente

[Dalja e trenit nga shinat në Normandi, dyshohet për sabotazh]

08:11 Bota / 1 koment

[Trump akuzon Iranin për sulmin ndaj tubacionit të naftës në Arabinë Saudite]

08:00 Bota / 1 koment

[Panik në Bruksel/ Droni i panjohur pikaset në hapësirën ajrore të aeroportit të qytetit, ndërpriten uljet dhe ngritjet për 30 minuta]

23:00 Bota

[Paguan mbi 200 mijë dollarë që trupi të ngrijë pas vdekjes, brenda qendrës që premton një “shans të dytë”]

22:50 Bota / 6 komente

[Kishin dalë për peshkim, 15-vjeçari shpëtohet në Alaskë pas dy ditësh në varkën e përmbysur. Dy viktima]

21:20 Bota / 1 koment

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**[Unë jam me Petrit Malajn]**

14:45 Blog / 59 komente

**[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...]**

15:15 Rajoni / 66 komente

**BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...**

14:30 Rajoni / 31 komente

**John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?**

11:40 Blog / 20 komente

**VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...**

10:02 Politika / 7 komente

## Blog Tema

**EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"**

10:30 Blog / 1 koment

**Demokracia jonë pa hardware dhe software?!**

08:23 Blog / 6 komente

**Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike**

18:43 Blog

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.